

My Love for the Savior Is My “Why”

By Elder Ricardo P. Giménez
Of the Seventy

Dashuria Ime për Shpëtimtarin Është Arsyeja Ime Pse

Nga Plaku Rikardo P. Himenez,
i Të Shtatëdhjetëve

April 2025 general conference

I love our Savior. This is the real and most powerful reason why I do what I do.

Have you ever noticed that our dear prophet, President Russell M. Nelson, continuously extends invitations to us? Not surprisingly, he has invited us to study and ponder the messages shared at the last two conferences. In April 2024, he said, “I hope you will repeatedly study the messages of this conference throughout the coming months.” Then, in October 2024, he said: “I urge you to study [the speakers’] messages. Use them as a litmus test of what is true and what is not during the next six months.”

These invitations can be added to prophetic invitations we have received throughout our lifetimes, including and especially those we have received in recent years. We may feel or think these invitations are another thing we need to add to our to-do lists, simply because we were invited or asked to do it. But could there be more to it?

Pondering over this and all the invitations we had received, I recalled something that I learned and decided long ago. I am trying to do these things which are essential to me because I love Him; I love our Savior. This is the real and most powerful reason why I do what I do, and then connected with this is my love for you, my fellow brothers and sisters.

As your brother, I hope you will consider my words as a sincere invitation to seek to understand the opportunity to link everything we do with our love for the Savior.

Doing this will help us understand the real

E dua Shpëtimtarin tonë. Kjo është arsyeja e vërtetë dhe më e fuqishme pse e bëj atë që bëj.

A e keni vënë re ndonjëherë se profeti ynë i dashur, Presidenti Rasëll M. Nelson, na bën vazhdimisht ftesa? Jo pa qëllim, ai na ka ftuar t’i studiojmë dhe t’i përsiatim mesazhet që na u dhanë në dy konferencat e fundit. Në prill 2024, ai tha: “Shpresoj se ju do t’i studioni në mënyrë të përsëritur mesazhet e kësaj konference gjatë gjithë muajve të ardhshëm”. Më pas në tetor 2024, ai tha: “Ju nxit t’i studioni mesazhet e [folësve]. Përdorini ato si një provë me lakmus për atë që është dhe nuk është e vërtetë, gjatë gjashtë muajve të ardhshëm.”

Këto ftesa mund t’u shtohen ftesave profetike që kemi marrë gjatë gjithë jetës, duke përfshirë dhe veçanërisht ato që kemi marrë vitet e fundit. Ne mund të ndiejmë ose mendojmë se këto ftesa janë një gjë tjetër që duhet të shtojmë në listat e gjërave që kemi për të bërë, thjesht sepse na u bë ftesë ose na u kërkua ta bëjmë. Mirëpo, a mund të ketë diçka më shumë pas kësaj?

Duke përsiatur për këtë dhe për të gjitha ftesat që kishim marrë, më erdhi ndër mend diçka që e mësova dhe e vendosa shumë kohë më parë. Po përpiqem t’i bëj këto gjëra, të cilat janë thelbësore për mua, sepse e dua Atë; e dua Shpëtimtarin tonë. Kjo është arsyeja e vërtetë dhe më e fuqishme pse e bëj atë që bëj, dhe më pas, e lidhur me këtë, është dashuria ime për ju, bashkëvëllezërit dhe motrat e mia.

Si vëllai juaj, shpresoj që t’i konsideroni fjalët e mia si një ftesë e sinqertë me synimin që të kuptoni mundësinë për të bërë lidhjen e gjithçka-je që bëjmë, me dashurinë tonë për Shpëtimtarin.

Bërja e kësaj na ndihmon të kuptojmë

“why” behind everything we do as disciples of the Savior. This will help us strengthen our covenantal connection with God, understanding His divine and eternal truths—His eternal and absolute truths that will never change. Eternal truths like “For God so loved the world, that he gave his only begotten Son, that whosoever believeth in him should not perish, but have everlasting life.”

It is interesting that sometimes because we have consistently done things to the point that they have turned into traditions, we allow these traditions or activities to dictate our efforts to build faith in Jesus Christ. It seems that we do these things because we have done them for many years, without considering their impact on our covenantal connection with the Savior.

In our world, we usually focus on what we do and on consistently accomplishing tasks and goals. In a spiritual sphere, we have the opportunity to go beyond just doing things or achieving goals by understanding why we are doing them. If we can understand and connect that the reason behind our actions relates to our love for the Savior and our Heavenly Father, by taking advantage of these opportunities we will understand that even though doing righteous things like having Church activities or traditions and appropriately doing them is a good thing, when we connect them with the “why,” we will be blessed to understand the reason. It won’t be just doing good things or doing them right; we will also get them right.

For example, when you set a goal to read the scriptures, offer sincere prayers, or prepare an activity for your family or ward, is the real goal simply to accomplish these tasks? Or are these actions the means, the tools at your disposal, to achieve the true goal? Is the purpose merely to hold an activity because we have done it for many years and then check the box that we have completed it? Or, once again, are these the means we use to learn, to feel, and to connect with the Savior?

Please don’t misunderstand my point about having activities and traditions or setting goals and working hard to achieve them; there is nothing wrong with this. However, I invite you to open your hearts and minds to the opportunity

arsyen e vërtetë pse për gjithçka që bëjmë si dishepuj të Shpëtimtarit. Kjo do të na ndihmojë ta forcojmë lidhjen tonë besëlidhëse me Perëndinë, duke kuptuar të vërtetat e Tij hyjnore dhe të përjetshme – të vërtetat e Tij të përjetshme dhe absolute që nuk do të ndryshojnë kurrë. Të vërteta të përjetshme si: “Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme”.

Është interesante që ndonjëherë, për shkak se i kemi bërë vazhdimisht gjërat deri në atë pikë sa ato janë kthyer në tradita, ne lejojmë që këto tradita ose veprimtari të na diktojnë përpjekjet për të ndërtuar besimin te Jezu Krishti. Duket sikur i bëjmë këto gjëra sepse i kemi bërë prej shumë vitesh, pa marrë parasysh ndikimin e tyre në lidhjen tonë besëlidhëse me Shpëtimtarin.

Në botën tonë, ne zakonisht përqendrohemi në atë që bëjmë dhe në përmbushjen e vazhdueshme të detyrave dhe synimeve. Në një sferë shpirtërore, ne kemi mundësinë të shkojmë përtej thjesht bërjes së gjërave ose arritjes së synimeve, duke kuptuar pse po i bëjmë ato. Nëse mundemi ta kuptojmë dhe të bëjmë lidhjen e arsyëja prapa veprimeve tona lidhet me dashurinë tonë për Shpëtimtarin dhe Atin tonë Qiellor, duke përfituar nga këto mundësi, do të kuptojmë se megjithëse bërja e gjërave të drejta, të tilla si bërja e veprimtarive apo pasja e traditave në Kishë dhe bërja e tyre siç duhet, është diçka e mirë, kur i lidhim ato me arsyen pse, ne do të bekohemi duke e kuptuar arsyen. Ajo nuk do të jetë që të bëjmë thjesht gjëra të mira apo t’i bëjmë siç duhet; do t’i bëjmë për arsyen e duhur.

Për shembull, kur vendosni një synim për të lexuar shkrimet e shenjta, për të bërë lutje të sinqerta ose për të përgatitur një aktivitet për familjen apo lagjen tuaj, a është synimi i vërtetë thjesht përmbushja e këtyre detyrave? Apo këto veprime janë mjetet, instrumentet që keni në dorë për të arritur synimin e vërtetë? A është qëllimi thjesht të zhvillojmë një aktivitet ngaqë e kemi bërë prej shumë vitesh dhe më pas të shenjojmë kutizën që e kemi kryer atë? Ose, sërish, a janë këto mjetet që përdorim për të mësuar, ndier dhe për t’u lidhur me Shpëtimtarin?

Ju lutem, mos ma keqkuptoni idenë rreth bërjes së aktiviteteve ose pasjes së traditave apo rreth vendosjes së synimeve dhe të punuarit fort për t’i arritur ato; nuk ka asgjë të gabuar këtu. Megjithatë, ju ftoj të hapni zemrën dhe mendjen

and blessing of understanding why we do these things and how we practice our religion.

A prime example of Christ-centered traditions is the challenge President Dallin H. Oaks extended to all of us in the name of the First Presidency. President Oaks said: “As we enter this new year, let us prepare for an Easter celebration of the atoning sacrifice of Jesus Christ. ... No matter what others believe or do, we should celebrate the Resurrection of our living Savior by studying His teachings and helping to establish Easter traditions in our society as a whole, especially within our own families.” As you can see, it is not just an invitation to have traditions. Instead, we use these traditions as a means to learn more about the Savior and remember His Resurrection.

The more we can connect the reason with our love for the Savior, the more we will be able to receive what we need or are seeking. President Nelson said, “Whatever questions or problems you have, the answer is always found in the life and teachings of Jesus Christ.” And then he extended this invitation: “Learn more about His Atonement, His love, His mercy, His doctrine, and His restored gospel of healing and progression. Turn to Him! Follow Him!”

Ponder this in your hearts and minds: Do you believe President Nelson’s invitation had the intention of helping us prepare a checklist where we will accumulate more knowledge and complete tasks so we can check off his invitation from our to-do lists? Or is he inviting us to consider the aspects of these eternal truths and principles as an opportunity to understand the “why” and connect the Savior’s covenantal love for us with our lifelong discipleship journey?

Let me illustrate the principle that I am trying to convey. One option, which is probably extreme, could be to read all the messages from general conference all at once; then, when I am done, I will check this invitation from my to-do list without doing anything else with what I read. I understand this is an extreme case, but it is not unreal. Probably, many are at some point between this and the ideal.

ndaj mundësisë dhe bekimit të të kuptuarit pse i bëjmë këto gjëra dhe si e praktikojmë ne fenë tonë.

Një shembull kryesor i traditave të përquendruara të Krishti, është sfida që Presidenti Dallin H. Oaks na drejtoi të gjithëve në emër të Presidencës së Parë. Presidenti Oaks tha: “Teksa hyjmë në këtë vit të ri, le të përgatitemi për kremtimin e Pashkës për hir të flijimit shlyes të Jezut Krishtit. ... Pavarësisht nga ajo që besojnë apo bëjnë të tjerët, ne duhet ta kremtojmë Ringjalljen e Shpëtimtarit tonë të gjallë duke i studiuar mësimet e Tij dhe duke ndihmuar në themelimin e traditave të Pashkës në shoqërinë tonë si një e tërë, sidomos brenda familjeve tona.” Siç mund ta shihni, kjo nuk është thjesht një ftesë për të pasur tradita. Përkundrazi, ne i përdorim këto tradita si mjete për të mësuar më shumë rreth Shpëtimtarit dhe për të kujtuar Ringjalljen e Tij.

Sa më shumë të mund ta bëjmë lidhjen ndërmjet arsyes me dashurinë tonë për Shpëtimtarin, aq më shumë do të jemi në gjendje të marrim atë që na nevojitet ose që po kërkojmë. Presidenti Nelson tha: “Çfarëdo pyetjesh apo problemesh të keni, përgjigjja gjendet gjithmonë në jetën dhe mësimet e Jezut Krishtit”. Më pas, ai bëri këtë ftesë: “Mësoni më shumë për Shlyerjen e Tij, dashurinë e Tij, mëshirën e Tij, doktrinën e Tij dhe ungjillin e Tij të rivendosur të shërimit dhe përparimit. Drejtohuni tek Ai! Ndiqeni Atë!”

Përsiateni këtë në zemrën dhe mendjen tuaj: A besoni se ftesa e Presidentit Nelson kishte për qëllim të na ndihmonte të përgatitnim një listë ku do të grumbullonim më shumë njohuri dhe do të plotësonim detyrat në mënyrë që të mund ta shenjojmë si të kryer ftesën e tij nga lista jonë e detyrave? Ose, a po na fton ai që t’i konsiderojmë aspektet e këtyre të vërtetave dhe parimeve të përjetshme si një mundësi për të kuptuar arsyen pse dhe për të bërë lidhjen e dashurisë besëlidhëse të Shpëtimtarit ndaj nesh me rrugëtimin tonë të dishepullimit gjatë gjithë jetës?

Lejomëni ta ilustruj parimin që po përpiqem të përçoj. Një variant, që ndoshta është ekstrem, mund të jetë që t’i lexoj menjëherë të gjitha mesazhet nga konferenca e përgjithshme; pastaj, kur të kem mbaruar, ta shenjoj si të kryer këtë ftesë nga lista ime e detyrave pa bërë asgjë tjetër prej atyre që lexova. E kuptoj që ky është një rast ekstrem, por nuk është i pavërtetë. Ndofta, shumë njerëz janë diku në një pikë midis kësaj

The invitation is to study and ponder the messages from the general conference and use them to determine and understand what we each can do to improve.

When we accept the invitation, understanding the “why” behind it, we will have more opportunities to become closer to the Savior. We will begin to understand that because I love the Savior, I want to learn more about Him by studying the words of the living prophets. And because I love my fellow man, I will share the teachings of prophets, seers, and revelators with others, starting with my loved ones.

In both examples, you are doing a righteous thing. In one, the goal seems to be using the means that Heavenly Father and the Savior have given us, which are the messages shared during general conference. The second version embraces the profound blessing of gaining insight into the underlying reasons, offering a pathway to understand eternal truth and the blessings promised to all who make the teachings and life of our Savior, Jesus Christ, the focal point of their lives.

Dear brothers and sisters, I hope you can feel and see the importance of connecting our actions with our love for the Savior. In a globalized world, many voices will try to influence you and, if possible, lead you to believe that some fundamental truths of the restored gospel of Jesus Christ are unnecessary. These voices start with the essential truth of the need for a restoration in these the last days, including the necessity of having God’s kingdom on earth, represented by the restored Church of Jesus Christ of Latter-day Saints.

You may hear voices insisting that only a personal relationship or understanding with the Savior is sufficient and that religion or the restored Church is unnecessary or nonessential. I invite you to be slow to consider or even be immune to being influenced by these misleading ideas and to be quicker to remember what the Savior has been telling and teaching us since ancient times—beginning with the love of Heavenly Father and Jesus Christ for us and connecting our love for Them as the reason to follow Them.

dhe ideale.

Ftesa është që t’i studiojmë dhe t’i përsiatim mesazhet nga konferenca e përgjithshme dhe t’i përdorim për të përcaktuar dhe kuptuar atë që mund të bëjë secili prej nesh për t’u përmirësuar.

Kur e pranojmë ftesën, duke kuptuar arsyen që fshihet pas saj, do të kemi më shumë mundësi për t’u bërë më të afërt me Shpëtimtarin. Ne do të fillojmë të kuptojmë se ngaqë e dua Shpëtimtarin, dua të mësoj më shumë rreth Tij duke i studiuar fjalët e profetëve të gjallë. Dhe ngaqë i dua bashkëqeniet e mia, do të flas për mësimet e profetëve, shikuesve dhe zbuluesve me të tjerët, duke filluar me njerëzit e mi të dashur.

Në të dy shembujt, ju po bëni një gjë të drejtë. Te njëri prej tyre, synimi duket se është të përdorim mjetet që na kanë dhënë Ati Qielor dhe Shpëtimtari, që janë mesazhet e dhëna gjatë konferencës së përgjithshme. Varianti i dytë e përqafon bekimin e rëndësishëm të marrjes së ideve që na çojnë drejt arsyeve prapa kësaj, duke ofruar një shteg për të kuptuar të vërtetat e përvetshme dhe bekimet e premtuara ndaj të gjithë atyre që i bëjnë këto mësimet dhe jetën e Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit, pikën ku përqendrohet jeta e tyre.

Të dashur vëllezër e motra, shpresoj që të mund ta ndieni dhe ta kuptoni rëndësinë që ka lidhja e veprimeve tona me dashurinë tonë për Shpëtimtarin. Në një botë të globalizuar, shumë zëra do të përpiqen të ndikojnë tek ju dhe, po të jetë mundësia, do t’ju shtyjnë të besoni se disa të vërteta themelore të ungjillit të rivendosur të Jezu Krishtit janë të panevojshme. Këto zëra fillojnë me të vërtetën thelbësore të nevojës për një rivendosje në këto ditë të fundit, përfshirë domosdoshmërinë e pasjes së mbretërisë së Perëndisë në tokë, të përfaqësuar nga Kisha e rivendosur e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Ju mund t’i dëgjoni zërat që ngulmojnë se mjafton vetëm një marrëdhënie vetjake me Shpëtimtarin ose një kuptueshmëri për Të dhe se feja apo Kisha e rivendosur është e panevojshme apo jo thelbësore. Ju ftoj që të jeni të ngadalshëm në marrjen parasysh të këtyre ideve devijuese apo qoftë edhe të fitoni imunitet nga ndikimi i tyre, dhe të jeni më të shpejtë për të kujtuar atë që na ka thënë dhe mësuar Shpëtimtari qysh në kohët e lashta – duke filluar nga dashuria e Atit Qielor dhe Jezu Krishtit për ne dhe nga bërja e lidhjes së dashurisë sonë për Ta si arsyeja pse duhet t’i

God the Father and His Son came and spoke with Joseph Smith to restore Jesus Christ's Church and to initiate the dispensation of the fulness of times, His kingdom on earth. Therefore, The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints is the means established by Heavenly Father to access covenants that enable us to return home. Thus, we need more than just a personal relationship with Heavenly Father and His Son; we require essential priesthood ordinances through which we make covenants with Them. This provides a covenantal connection with Them and grants us access to Their covenantal love, making it possible to attain the highest kingdom of glory prepared for all those who are true and faithful to their covenants.

With all the energy of my soul, I bear witness to the reality and divinity of our Savior, Jesus Christ. He loves you. He knows what is happening in your life. His arms are wide open, extending the invitation "Come unto me, ... and I will give you rest."

I love the Savior, and my love for Him is my "why." In the name of Jesus Christ, amen.

ndjekim Ata.

Perëndia Ati dhe Biri i Tij erdhën dhe i folën Jozef Smithit për të rivendosur Kishën e Jezu Krishtit dhe për të nisur periudhën e plotësisë së kohëve, mbretërinë e Tij në tokë. Si rrjedhim, Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, është mjeti i themeluar nga Ati Qiellor për të pasur të drejtën për besëlidhje që na mundëson të kthehemi në shtëpi. Prandaj, na nevojitet më shumë se një marrëdhënie vetjake me Atin Qiellor dhe Birin e Tij; na duhen ordianca thelbësore priftërie nëpërmjet të cilave bëjmë besëlidhje me Ta. Kjo siguron një lidhje besëlidhëse me Ta dhe na jep qasje te dashuria e Tyre besëlidhëse, duke bërë të mundur marrjen e mbretërisë më të lartë të lavdisë të përgatitur për ata që janë të vërtetë dhe besnikë ndaj besëlidhjeve të tyre.

Me gjithë fuqinë e shpirtit tim, ju jap dëshmi për realitetin dhe hyjninë e Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit. Ai ju do. Ai e di se çfarë po ndodh në jetën tuaj. Krahët e Tij janë të hapur gjatë e gjerë, duke na bërë ftesën: "Ejani tek unë, ... dhe unë do t'ju jap çlodhje".

E dua Shpëtimtarin dhe dashuria ime për Të është arsyeja ime pse. Në emrin e Jezu Krishtit, amen.